



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:  
“KORPUS UNIVERSITAR “UNIVERSITETI ALDENT”, LUNDËR, FARKË, BASHKIA  
TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit Adem Alushi, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Korpus Universitar “Universiteti Aldent”, Lundër, Farkë, Bashkia Tiranë”, me zhvillues Adem Alushi, miratuar me Vendimin Nr. 8, datë 20.06.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 8, datë 20.06.2018, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

BESA SHAHINI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

